



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHËTËRËTOR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:

Institucioni Kombëtar Opera dhe Baleti Kombëtar

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të llogarisë së buxhetit themelor (603) për vitin 2020.

Qëllimi i revizionit: Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare të marra në tërësi janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- mungesa e planeve vjetore dhe mujore për orarin e punës dhe akti i pamiruar për riaudicion të personave tashmë të punësuar në institucion;
- dobësi gjatë zbatimit të regjistrimit të mjeteve materiale, mallrat në stok dhe inventarit të vogël, si dhe mos regjistrimi i përfunduar i një pjese nga mjetet;
- pagesat e fondeve që nuk mbulohen ligjërisht dhe me fatura pa dokumentacion mbështetës;
- janë identifikuar dobësi të disa nga procedurat e kryera të prokurimit publik.

Rekomandimet kyçe:

- miratimi i planeve vjetore dhe mujore për orarin e punës dhe zbatimi i procedurës së riaudicionit;
- zbatimi i regjistrimit të plotë të mjeteve dhe detyrimeve dhe harmonizimi i kontabilitetit me gjendjen faktike;
- përmirësimi i nivelit të konkurrencës gjatë realizimit të procedurave të prokurimit publik.

Vërejtjet e marra të Draft-Raportit:

Janë marrë vërejtje të Draft-Raportit nga ana e drejtorit të institucionit.

Mendimi i dhënë *:

Është shprehur mendim i pavoritshëm në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e paraqitur të gjendjes financiare dhe rezultatet nga aktivitetet financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksionit financiar me rregullativën relevante ligjor, udhëzimet dhe politikat e vendosura për vitin 2020.

Dobësitë kyçe të sistemit:

- dobësitë në pjesën e financimit të institucioneve në fushën e kulturës;
- intensifikimi i aktiviteteve për formimin e grupit punues të Ministrisë së Kulturës, Operës dhe Baletit të Maqedonisë dhe Filarmonisë së Maqedonisë në bashkëpunim me Radio Televizionin e Maqedonisë për zbatimin e planit të veprimit për zhvillim kulturor përmes analizës së kapacitetit të kuadrit të nevojshëm dhe në dispozicion në drejtim të realizimit i plotë i Strategjisë kombëtare për zhvillimin e kulturës në Republikën e Maqedonisë;
- Dobësi në Ligjin për Kulturë për punësimin e artistëve të kategorisë A në IK, që ndikon në arritjen e cilësisë në vepër.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Një vërejtje është pranuar pjesërisht, ndërsa të tjerat janë koment për kushtet e përcaktuara dhe nuk është pranuar asnjë dëshmi shtesë që do të ndikonte në ndryshimin e gjendjes së konstatuar në raport

* pozitive, me rezervë, të pavoritshëm, të përmbajtur